



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 18.11.2022

KËRKESË

KËRKUES: 14 DEPUTETË TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË (JO MË PAK SE 1/10 E DEPUTETËVE), me adresë njoftimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve.
2. Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 83, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Shqipërisë.
3. Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 84, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për kërkesat mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 70, 71, 131, gërma “ç” të Kushtetutës së Shqipërisë; Nenet 27, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

DREJTUAR: GJYKATËS KUSHTETUESE

E Nderuar Znj. Kryetare,

Të Nderuar Gjyqtarë,

Në datën 17.11.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr. 83 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”, dhe vendimin nr. 84 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetin për kërkesat mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”. Duke qenë se vlerësojmë se këto akte vijnë në kundërshtim me nenin 70, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, po parashtrojmë këtë kërkesë me faktet, provat, të drejtën e aplikueshme dhe arsyetimin ligjor, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe deklarimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

I. HYRJE

1. Në datën 20.06.2022, protokolluar nga Kuvendi me nr. 2283 prot., katërmëdhjetë deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, jo më pak se 1/10 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, kanë dorëzuar një mocion me objekt: “*Kërkohe ndjekja e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhacca*.”. Në përmbajtje të kësaj kërkesë argumentohet gjithësisht se deputetja e Kuvendit të Shqipërisë, e cila aktualisht mban edhe postin e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Olta Xhacca ka ushtruar funksionin e deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka kryer veprimtari fitimprurëse me pasuri të shtetit, nga shoqëria tregtare në pronësi të bashkëshortit të saj, Z. Artan Gaci.

2. Pas depozitimit të kësaj kërkesë, me urdhërin nr. 57, datë 22.06.2022, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Lindita Nikolla ka urdhëruar: “*I. Thirrjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, datë 24.06.2022, ora 10:30 në Kryesinë e Kuvendit. II. Rendi i ditës është si më poshtë: Shqyrtimi i mocionit të 1/10 të deputetëve përfaqësues të Grupit Parlamentar*

të Partisë Demokratike për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaka.”.

3. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ka zhvilluar pesë mbledhje për shqyrtimin e mocionit të 1/10 së deputetëve të Grupit Parlamentar të PD-së lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaka, përkatësisht në datat 24.06.2022, 01.07.2022, 08.07.2022, 15.07.2022 dhe 16.09.2022. Gjatë këtyre katër mbledhjeve është bërë prezantimi i mocionit nga përfaqësuesit e 1/10 së deputetëve, janë paraqitur dokumentet shoqëruese të mocionit, nismëtarët e mocionit iu janë përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të Këshillit dhe është dëgjuar mendimi i avokatit mbrojtës të Znj. Xhaka.

4. Në mbledhjen e datës 16 09 2022, të thirrur me kërkesë të pesë anëtarëve, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, ka vazhduar shqyrtimi i mocionit të paraqitur lidhur me mandatin e Znj. Xhaka. Gjatë kësaj mbledhjeje, është konstatuar përfundimi i shqyrtimit të kërkesës dhe është vendosur unanimisht që palëve t’u jepet një afat 2-javor për paraqitjen e raportit përfundimtar që do t’i përcillet më pas për shqyrtim dhe miratim seancës plenare. Afati 2-javor përkonte me datën 30.09.2022. Në zbatim të këtij vendimi, relatori i caktuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputeti Gazment Bardhi ka përgatitur raportin përfundimtar, i depozituar në Kuvendin e Shqipërisë me shkresën nr. 2402/1 prot., datë 10.10.2022.

II. RRETHANAT E CËSHTJES

5. Ligji për investimet strategjike është miratuar në 28 Maj 2015 dhe ka hyrë në fuqi në 17 Tetor 2015. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit, konkretisht më datë 21 Tetor 2015, është krijuar shoqëria tregtare AG.TCC shpk, me objekt veprimtarie investime në hoteleri-turizëm. Kjo kompani e krijuar vetëm 4 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit për investimet strategjike, rezulton se është në pronësi të Z. Artan Gaçi, i cili është administrator dhe ortak i vetëm i saj. Z. Artan Gaçi rezulton se është bashkëshorti i deputetes së Partisë Socialiste dhe Ministres për Europën dhe Punët e Jashtme znj. Olta Xhaka.

6. Kompania e krijuar menjëherë pas miratimit të ligjit për investimet strategjike AG.TCC sh.p.k. në pronësi të bashkëshortit të ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacker, me vendimin nr. 3/5, datë 29.03.2021 “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES”, me subjekt “AG.TCC” sh.p.k, me NUIS L52227046H” të Komitetit të Investimeve Strategjike, ka përfituar statusin e investitorit strategjik për ndërtimin e një hoteli disa katësh me 5 yje në një sipërfaqe zhvillimi prej 10,592 m² dhe me vlerë rreth 5,5 milion euro, në Gjilekë, Bashkia Himarë. Ndër të tjera vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike parashikon masat lehtësuese që përfiton kompania në pronësi të bashkëshortit të Ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacker.

7. Në përputhje me Vendimin e KIS nr. 3/5 datë 29.03.2021, shoqëria në pronësi të bashkëshortit të ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacker ka përfituar masën mbështetëse të lejimit të përdorimit të bregut para hotelit për një periudhë 30 vjeçare. Sipas vendimit, shoqëria investuese synon që zonën e bregdetit ta përdorë ekskluzivisht për zhvillimin e veprimtarisë turistike në shërbim të hotelit që po zhvillohet dhe, për këtë qëllim, në këtë zonë planifikohet të instalohen disa stacione plazhi, ku synohet të ofrohet shërbim i cilësisë së lartë, në përputhje edhe me standardet më të mira ndërkombëtare. Për këtë arsye, por edhe me qëllim që subjekti investues të përfitojë nga incentiva e reduktimit të TVSH-së, sipas pikës 2, neni 11/1 i VKM nr. 953 datë 29.12.2014, subjekti investues ka krijuar një shoqëri të dedikuar (SPV).

8. Në datën 25.06.2021, znj. Taëni Lin Grzych-Sutton, shtetase amerikane e lindur më 1990 dhe banuese në Rezidencën “Kodra e Diellit”, Nr. 22, Shk. 298, Ap. 14, Tiranë, Shqipëri, partnerja e vëllait të deputetes Xhacker, Z. Andi Xhacker, ka krijuar me një kapital prej 500 milion lekesh shoqërinë AGTCC HOTEL MANAGEMENT, me objekt veprimtarie “shërbim hoteleri turizëm”. 5 ditë pas krijimit, shoqëria AGTCC HOTEL MANAGEMENT sh.p.k. nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “AG.TCC” sh.p.k., në pronësi të bashkëshortit të ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacker për administrimin e pasurisë publike, që ky i fundit ka përfituar si investitor strategjik, pra brigjet e detit dhe plazhin në zonën e Gjilekës, Bashkia Himarë. Pra, aktualisht shoqëria investuese “AG.TCC” sh.p.k. ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi nr. rep. 695, nr. kol. 420, datë 30.06.2021, me shoqërinë “AGTCC HOTEL MANAGEMENT” sh.p.k., për operimin e strukturave turistike në projektin Dreamades Luxury Suits, ku përfshihet

edhe operimi i stacioneve të plazhit në bregun përballë hotelit, duke luajtur kështu rolin e një shoqërie të dedikuar (SPV).

9. Kjo marrëveshje vetëm 15 ditë më vonë, më datë 15 Korrik 2021 reflektohet në një tjetër vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 3/9, datë 15/07/2021 *“Për një ndryshim në vendimin nr. 3/5 datë 29.03.2021 të KIS “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES”, me subjekt “AG.TCC” sh.p.k., me NUIS L52227046H, ku konfirmohet përfitimi i statusit të investitorit strategjik, masat mbështetëse dhe e drejta për përdorimin e pasurisë publike – brigjeve të detit dhe plazhit, si dhe reflektohet marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur midis dy shoqërive.*

10. Në vijim, me vendimin nr. 137, datë 2 Mars 2022 *“Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “DREAMADES LUXURY SUITES”, Këshilli i Ministrave ka konkretizuar dhënien e të drejtës së përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit për shoqërinë investuese, duke detyruar Bashkinë Himarë të lidhë kontratën me to. Konkretisht, Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “AGTTC Hotel Management” sh.p.k., me NUIS M11825022K, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, të lejuara me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë.*

11. Dhënia e pasurisë publike për qëllime fitimi dhe ushtrimi të veprimtarive fitimprurëse, është bërë në shkelje flagrante të ndalimeve kushtetuese dhe ligjore, që ndalojnë deputetin dhe për efekt të ligjit bashkëshortin e tij, të përfitojë pasuri të shtetit apo të kryejë veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuritë e shtetit. Ky fakt përbën shkelje të rëndë të ligjit, që passjell mbarimin/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, sipas nenit 71/2/c të Kushtetutës.

III. E DREJTA E APLIKUESHME

12. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

(i) Neni 70 parashikon se: “1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. 2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. **Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.** 3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. 4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.”.

(ii) Neni 71 parashikon se: “1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve. 2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit: a) kur ai nuk bën betimin; b) kur heq dorë nga mandati; c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3; ç) kur mbaron mandati i Kuvendit; d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend; dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.”.

13. Kodi i Familjes:

(i) Neni 74 parashikon se: “Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose vec e vec, gjatë martesës; b) të ardhurat e fituara nga veprimtaria e vecantë e cdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së cdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.”

14. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar:

(i) Neni 5 parashikon se: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesu që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: dh) marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës. 2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku

me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.”

(ii) Neni 21 parashikon se: *“1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.”*

(iii) Neni 24 parashikon se: *“1. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es. 3. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni.”*

(iv) Neni parashikon se: *“Ministri: c) nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.”*

(v) Neni 28 parashikon se *“Deputeti: a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër; c) nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.”*

(vi) Neni 35 parashikon se: *“1. Person i lidhur, për qëllim të neneve 27 deri 33 të këtij ligji, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet e tjera të këtij seksioni, janë vetëm bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es. 2. Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëjloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit dhe personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore për to, në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit.”*

(vii) Neni 45 parashikon se: “1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve. Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse, njoftohet rast pas rasti Inspektorati i Larte. 2. Për zyrtarët, që njësohen ose janë anëtarë të organeve kushtetuese, zbatohen masat dhe procedurat e përcaktuara nga Kushtetuta dhe dispozitat ligjore përkatës.”

15. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese:

(i) Vendimi nr. 44, datë 07.10.2011 (rasti i deputetit Ilir Beqja): “*Papajtueshmëria me funksionin e deputetit nënkupton që deputeti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër përveç atij të anëtarit të parlamentit ose anëtarit të qeverisë. Në thelb papajtueshmëria përqendrohet në dy aspekte: e para lidhet me ndalimin për të mbajtur dy funksione publike, e dyta, me ndalimin për të mbajtur një funksion publik dhe një privat me karakter ekonomik (ose jo). Në të dyja rastet, ndalimi për të mbajtur dy funksione/detyra synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ dhe në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe si rrjedhojë të shtetit të së drejtës. Gjithashtu, ndalimi i ushtrimit të më shumë se një funksioni/detyre parashikohet për të garantuar edhe angazhimin e plotë dhe pa rezerva të funksionarit në kryerjen e detyrës së marrë përsipër prej tij, gjë e cila mund të reduktohej ose të bëhej e pamundur për shkak të angazhimit të veçantë që kërkon kryerja e njëkohshme e dy detyrave nga funksionari. Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit të dhënë dhe garancitë e paanshmërisë së të zgjedhurit. Ai konsiston në pamundësinë juridike për të mbajtur një detyrë për të cilën subjekti është zgjedhur në mënyrë të vlefshme ose të zhvillojë disa aktivitete të caktuara të konsideruara nga ligjvënësi si të papajtueshme me mandatin elektorale. Për papajtueshmërinë, si koncept ndalues i kryerjes së më shumë se një detyre/funksioni, nuk është e rëndësishme nëse funksionari bie në kushtet e përfitimit për shkak të detyrës ose jo ose në konflikt interesi midis detyrës së tij dhe interesave privatë. Vetëm fakti i ushtrimit të dy funksioneve/detyrave (publike-publike, publike-private) mjafton që ai të konsumojë këtë ndalim. Deputeti nuk duhet të*

kujdeset për të ardhurat e tij gjatë kohës që ushtron detyrën, me qëllim përmbushjen sa më mirë të funksionit për të cilin ai është zgjedhur.”

(ii) Vendimi nr. 32/2016 (rasti i deputetit Koco Kokëdhima: “Instituti i papajtueshmërisë shfaqet, nga njëra anë, si mekanizmi që ka për qëllim mbrojtjen e pavarësisë së mandatit parlamentar dhe, nga ana tjetër, si reagimi ndaj detyrimit të parandalimit të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Në mënyrë që një anëtar i Parlamentit të jetë në gjendje të kryejë detyrat e tij si përfaqësues i popullit, vetë Kushtetuta ka përcaktuar jo vetëm disa të drejta, por edhe disa detyrime për të. Qëllimi i rregullimit kushtetues të nenit 70 të Kushtetutës është të sigurojë ushtrimin e mandatit të lirë nga ana e deputetit, për të garantuar që ai do të veprojë në interes të popullit dhe jo në interesin e tij personal ose të një grupi të caktuar. Kjo i shërben parimit të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve dhe parimit të demokracisë, ku çdo funksionar publik duhet të ushtrojë me të gjitha forcat dhe energjitë e veta detyrën për të cilën është zgjedhur ose emëruar, detyrë të cilën ai e ka pranuar me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë. E kundërta mbart, natyrshëm, dyshime lidhur me besueshmërinë e publikut në cilësinë e përfaqësimit të tij. Me qëllim evitimin e papajtueshmërisë me detyrën, deputeti ka detyrimin të marrë masat e duhura për përfaqësimin sa më të mirë të zgjedhësve dhe ushtrimin e mandatit të tij konform detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, çka duhet të fillojë që në periudhën parazgjedhore (përfshi këtu edhe fushatën zgjedhore). Përgatitja për marrjen e një funksioni publik përfshin, përpara detyrimeve ligjore, edhe plotësimin e detyrimeve morale dhe shoqërore kundrejt publikut. Deputeti duhet të marrë të gjitha masat për të shmangur çdo situatë papajtueshmërie apo konflikti interesi që mund të lindë në momentin e marrjes (fillimit) së mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës që ai vazhdon. Veprimet konkrete për këtë qëllim nevojiten të merren më së voni deri në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe qartësia te deputeti për të ardhurat e tij financiare. Gjykata, bazuar në nenin 70/3 të Kushtetutës, vlerëson se shmangia e fitimeve/të ardhurave nga buxheti i shtetit është një detyrim që buron drejtpërdrejt nga kjo dispozitë, e cila ndalon shprehimisht jo vetëm kryerjen e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor, por edhe që “të fitohen pasuri të këtyre”, pavarësisht mënyrës se si fitohen ato. Në vlerësimin e Gjykatës neni 70/3 i Kushtetutës e lidh papajtueshmërinë me funksionin e deputetit me momentin e ushtrimit të veprimtarisë konkrete fitimprurëse apo ardhjes së të ardhurave nga kjo veprimtari, e cila nuk duhet të përkojë me kohën gjatë së cilës deputeti ushtron funksionin e të zgjedhurit si përfaqësues i popullit. ...pavarësisht se vihet në lëvizje në bazë të nenit 70/3 të Kushtetutës, kjo dispozitë nuk mund të lexohet e shkëputur nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, i cili edhe pse në thelb ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, për sa u takon rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësisë dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit, referon te ligji nr.9367/2005. Përveç ndalimeve të sipërcituara, ky ligj ka

parashikuar edhe mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit. Është detyrë e deputetit, që në përputhje me të gjithë kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi, të marrin masat e duhura për të plotësuar detyrimet që rrjedhin me rastin e marrjes së mandatit parlamentar. Gjykata vlerëson se neni 70/3 i Kushtetutës dhe jurisprudenca kushtetuese nuk kanë bërë dallim në këtë drejtim midis personit juridik dhe atij fizik dhe midis veprimtarisë së kryer veçmas nga këto subjekte të së drejtës, si dhe nuk e kanë lidhur ndalimin me përfitimin drejtpërdrejt të deputetit nga veprimtaria e kryer.”

IV. ANALIZA LIGJORE

16. Parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive që lidhen me mandatin e deputetit përbën një garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe shmangien e konfliktit të interesit. Ndërsa, sipas pikës 2 të nenit 70 Kushtetuta jonë ia ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi e mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ka ai si anëtar i organit më të lartë përfaqësues.

17. Ajo që parashikohet e qartë në nenin 70/2 i Kushtetutës është ndalimi i ushtrimit të funksioneve të tjera nga deputeti menjëherë pas marrjes së mandatit të deputetit. Neni 70/3 e konsideron të papajtueshme me funksionin e deputetit ushtrimin e “*veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre*”. Ndalimet e tjera parashikohen me ligje të posaçme.

18. Nëse deputeti përveç pagës që do të merrte si i tillë, do të mund të merrte dhe të ardhura të tjera nga buxheti i shtetit për shkak të profesionit të tij primar, atëherë ky parim do të cenohet. Kjo i shërben parimit të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve dhe në fund të fundit parimit të demokracisë, ku çdo funksionar publik duhet të ushtrojë me të gjitha forcat dhe energjitë e veta detyrën për të cilën është zgjedhur ose emëruar, detyrë të cilën ai e ka pranuar me vullnetin e tij të

plotë dhe të lirë. E kundërta mbart, natyrshëm, dyshime lidhur me besueshmërinë e publikut në cilësinë e përfaqësimit të tij.

19. Neni 70/3, sic shprehet edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, nuk mund të lexohet e shkëputur nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, i cili edhe pse në thelb ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, për sa u takon rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit, referon tek ligji nr.9367/2005.

20. Ligji nr. 9367/2005 parashikon shprehimisht në nenin 35 të tij se *“në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur (që sipas ligjit është bashkëshorti), ato vlerësohen njëjloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit. Për pasojë, në kuptim të ligjit dhe për efekt të zbatimit të ndalimit kushtetues/ligjor, shoqëria tregtare AG. TCC sh.p.k. konsiderohet në pronësi të vetë ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacka. Për pasojë, përfitimet nga pasuria e shtetit, që burojnë nga vendimi nr. 3/5, datë 29/03/2021 “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES”, janë përfitime edhe të ministres dhe deputetes znj. Olta Xhacka.*

21. Kjo rrjedh natyrshëm edhe nga përcaktimet e Kodit të Familjes. Konkretisht, në nenin 74 të Kodit përcaktohet se *“Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose vec e vec, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e vecantë e cdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.”* Nga kjo dispozitë mund të deduktohet se cdo pasuri e krijuar gjatë martesës që i përket Z. Gaci, rrjedhimisht i përket edhe znj. Xhacka, përfshirë këtu edhe shoqëria tregtare “AG.TCC” sh.p.k., duke qenë se kjo e fundit është krijuar pas lidhjes së martesës. Kjo do të thotë se përfitimi nga ana e kësaj shoqërie e të drejtave mbi pasuritë e shtetit, duhet konsideruar njësoj sikur të kishte përfituar vetë deputetja dhe ministria Znj. Xhacka.

22. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton e provuar se shoqëria tregtare AG. TCC sh.p.k. ka përfituar të drejtën për të kryer veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit dhe pushtetit vendor, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në fushën e turizimit, në kohën në të cilën ka ushtruar mandatin e deputetit. Ky fakt bie ndesh me ndalimin kushtetues të parashikuar nga neni 70/2-3 i Kushtetutës dhe është tërësisht i mjaftueshëm për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit për znj. Olta Xhacka.

23. Sipas ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike: *vija bregdetare për të hyrë në tokë*. Për pasojë, lejimi i përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Dreamades Luxury Suites”, Gjilekë, Himarë, nga ana e shoqërisë tregtare AG. TCC sh.p.k. nënkupton që ajo do të kryejë veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit. Për më tepër, kjo veprimtari fitimprurëse, për shkak të përfitimit të trajtimit preferencial sipas ligjit për investimet strategjike, përfiton edhe reduktim të vlerës së TVSH-së, që janë të ardhura të Buxhetit të Shtetit.

24. Nga ana tjetër, paragrafi 2 i nenit 70 të Kushtetutës parashikon shprehimisht se: *“Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.”*. Një nga ligjet që parashikon edhe rastet e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit është edhe **ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar**. Neni 28 i këtij ligji parashikon shprehimisht se: *“Deputeti: a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër; c) nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.”*. I njëjti ndalim edhe më i rreptë vepron edhe për zyrtarin që ushtron funksionin kushtetues të ministrit.

25. Zotërimi i aksioneve në shoqërinë “AG.TCC” sh.p.k., duke mos respektuar ndalimet ligjore, përbën shkelje flagrante të ndalimit të parashikuar nga shkronja “a” e nenit 28 të ligjit nr. 9367/2005. Përsa më lart, në rastin konkret vërtetohen kushtet e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, të parashikuara me ligj, edhe në kuptim të nenit 70/2 të Kushtetutës. Në bazë të nenit 71/1 të Kushtetutës mandati i saj parlamentar konsiderohet i fituar në momentin e shpalljes së deputet nga KQZ-ja në vitet 2013, 2017 dhe 2021. Deputetja znj. Olta Xhacker kishte detyrimin që në momentin e shpalljes së saj fituese nga KQZ-ja të shmangte çdo rast të papajtueshmërisë, duke përfshirë ndalimin e përfitimit të fondeve publike nga shoqëria tregtare, por edhe papajtueshmërinë e parashikuar në dispozitat e ligjit nr. 9367/2005. Deputeti ka përgjegjësi individuale për ushtrimin e detyrës së tij dhe nuk mund të justifikojë veprimet e tij jokushtetuese me situata të tjera jokushtetuese apo joligjore. Në vendimin nr. 44/2011, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“Deputeti ka detyrimin që në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, pavarësisht se kur bën betimin, të sillet si deputet”*.

V. PROCEDURA PARLAMENTARE

26. Pas konstatimit të fakteve të sipërmendura, studimit të së drejtës së aplikueshme dhe një analize ligjore të kujdesshme, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka konkluduar se deputetja e PS-së, Znj. Olta Xhacker, njëkohësisht me detyrë ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, cka duhet të sjellë edhe përfundimin e mandatit të saj. Për këtë arsye, me shkresën nr. 2283 prot., datë 20.06.2022, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me një mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetës Znj. Olta Xhacker.

27. Pas marrjes së këtij mocioni, kryetarja e Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla me urdhërin nr. 57, datë 22.06.2022, protokolluar me nr. 2283/1 prot., datë 22.06.2022, ka urdhëruar mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në datën 24.06.2022, ora 10:30 me rend dite shqyrtimin e mocionit të 14 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetes Olta Xhacker.

28. Në mbledhjen e datës 24.06.2022, ora 10:30, pas celjes së mbledhjes, kryetarja e Kuvendit është shprehur se *“Kuvendi nuk vë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk ia nënshtron atë debatit parlamentar, pasi nuk i hyn themelit të çështjes për të vlerësuar nëse veprimet konkrete të pretenduara si të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij. Vlerësimi i meritës së çështjes, nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.”* Pasi fjalës së kryetares, fjala i është dhënë kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së, Z. Enkelejd Alibeaj, i cili ka shpjeguar se kërkesa e paraqitur i përmban të gjithë elementët formalë, përfshirë numrin e nënshkrimeve, provat dhe dokumentacionin shoqëruar dhe një analizë ligjore shtetuese sa i përket kriteve kushtetuese të përcaktuara në nenin 70, pika 3 të Kushtetutës. Deputetja Klotilda Bushka ka kërkuar, që për shkak të angazhimit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, t’iu jepet një kohë e caktuar në mënyrë që të njihen me kërkesën dhe dokumentacionin shoqëruar. Kërkesa është pranuar nga kryetarja e Kuvendit, e cila ka vendosur shtyrjen për t’iu dhënë kohë deputetëve të studiojnë dokumentacionin e paraqitur.

29. Në mbledhjen e dytë, datë 01.07.2022, ora 12:00, pas celjes së mbledhjes nga kryetarja e Kuvendit, fjala i është dhënë deputetit Saimir Korreshi për të prezantuar mocionin, në emer të deputetëve nënshkrues. Deputeti Korreshi ka bërë një parashtrim të të gjitha fakteve, bazës ligjore dhe jurisprudencës kushtetuese, përthyerjes së fakteve me të drejtën e aplikueshme, duke konkluduar se Znj. Olta Xhacker është në kushtet e papajtueshmërisë, në kuptim të nenit 70, pikat 2 dhe 3, e për rrjedhojë çështja duhet t’i dërgohet Gjykatës Kushtetuese për të deklaruar mbarimin e mandatit të saj. Gjatë mbledhjes ka pasur diskutime lidhur me pasurinë shtetërore që përdor apo nga e cila përfiton deputetja Xhacker. Në përgjigje të kësaj pyetje, deputeti Gazment Bardhi është shprehur se deputetja Xhacker është bashkëpronare mbi shoqërinë AG.TCC sh.p.k., në masën 50% për shkak të përcaktimeve të nenit 74 e vijues të Kodit të Familjes. Në këtë kuptim, të drejtat e përfituara nga kjo shoqëri mbi pasurinë shtetërore, duhet konsideruar si të përfituara drejtpërdrejtë nga deputetja. Deputeti Bardhi ka shpjeguar në mbledhje së në zbatim të drejtë të vendimit nr. 7/2016 të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ka detyrimin t’ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese për të bërë vlerësimin e themelit të pretendimeve të ngritura, dhe se Kuvendi nuk mund t’i hyjë shqyrtimit në themel. Në përfundim të mbledhjes, kryetarja e Kuvendit ka informuar deputetët se

është bërë njoftimi i deputetes dhe ministres Olta Xhacka, e cila do të dëgjohej në mbledhjen e ardhshme.

30. Në mbledhjen e tretë, datë 08.07.2022, i pranishëm në mbledhje ishte edhe avokati mbrojtës i deputetes Olta Xhacka, Z. Genc Cifligu. Ky i fundit parashtroi gjërësisht qëndrimin e Znj. Xhacka, duke shpjeguar se gjithë veprimtaria e shoqërisë “AG.TCC” sh.p.k., Z. Artan Gaci dhe Znj. Olta Xhacka ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Madje, për të mbështetur qëndrimin e tij, avokati solli në vëmendje vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me rastet e deputetëve Valentina Leskaj dhe Rakip Suli. Megjithatë, vlen për t’u sjellë në vëmendje në këtë pikë ndryshe nga rasti i ish deputetëve Leskaj dhe Suli, ku bëhej fjalë për përfitime të marra nga fëmijët e deputetëve, të cilët rezultojnë formalisht të ndarë në gjendjen civile nga trangu familjar, në këtë rast kemi të bëjmë me bashkëshortë, kur për shkak të rregullimeve të nenit 74 të Kodit të Familjes, çdo përfitim i njërit bashkëshort, konsiderohet edhe i tjetrit dhe anasjelltas. Në këtë kuptim, këto dy vendime janë të paaplikueshme në rastin konkret. Deputetët e Grupit Parlamentar të PD-së kërkuan fjalën për t’i drejtuar pyetje avokatit të Znj. Xhacka, por kjo nuk u lejua nga kryetarja e Kuvendit, e cila vendosi mbylljen e mbledhjes pas fjalës së gjatë të avokatit mbrojtës të deputetes Xhacka.

31. Në mbledhjen e katërt, datë 15.07.2022, ora 11:00, kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Z. Enkelejd Alibeaj ngriti shqetësimin se në mbledhjen e kaluar kishte ndodhur një shkelje procedurale për shkak se deputetëve iu ishte mohuar e drejta për të drejtuar pyetje dhe për të kërkuar shpjegime, në mënyrë që edhe deputetes t’i jepet mundësia për t’u dëgjuar në mënyrë thelbësore. Sipas deputetit Alibeaj, kjo bëhet me qëllim për të krijuar alibi mbrojtëse për shkelje procedurale, të cilat do të ngrihen në një moment të dytë në Gjykatën Kushtetuese. Gjatë kësaj mbledhje, është paraqitur edhe një mocion tjetër me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe lidhur me mandatin e deputetes Xhacka, nga një grup prej 15 deputetësh të opozitës. Në përfundim të prezantimit, avokati i Znj. Xhacka kërkoi një javë kohë për të paraqitur qëndrimin me shkrim ndaj kësaj kërkesë. Kjo u kundërshtua nga deputetët e Grupit Parlamentar të PD-së, si një përpjekje e qartë për zvarritje, megjithatë kryetarja e Kuvendit vendosi t’ia akordojë këtë kohë avokatit për të paraqitur kundërshtimet me shkrim.

32. Në mbledhjen e pestë, datë 16.09.2022, ora 09:30, deputetja Klotilda Bushka kërkoi që me qëllim që relatorët e çështjes, përkatësisht ajo dhe deputeti Gazment Bardhi, të kenë mundësi për të dalë me një raport të përbashkët, t'u jepet një afat 2-javor për përgatitjen e raportit që do t'i dërgohet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare. Kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Z. Enkelejd Alibeaj kërkoi që ky afat të respektohej me përpikëri, pasi dukej qartazi tendenca për ta shtyrë shqyrtimin e këtij mocioni, brenda një afati të arsyeshëm. Mbledhja u mbyll, duke iu dhënë një afat 2-javor relatorëve të çështjes për të punuar për përgatitjen e një raporti përfundimtar.

33. Në mbledhjen e gjashtë, datë 19.10.2022, deputeti Gazment Bardhi ka prezantuar raportin në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ndërsa deputetja Klotilda Bushka ka prezantuar raportin në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Ndërmjet pakicës dhe shumicës nuk ka pasur dakordësi për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, dhe raportet i kanë kaluar për shqyrtimin seancës plenare. Në datën 17.11.2022, me vendimin nr. 83, Kuvendi ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe miratimin e vendimit nr. 84 për raportin e mazhorancës.

34. Ky vendim vjen në kundërshtim me nenin 70, pika 4 të Kushtetutës, i cili siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese, përcakton se në rast se Kuvendi i Shqipërisë vihet në lëvizje me mocion të kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit (shih vendimin nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Në këto kushte, është e qartë se vendimi nr. 83/2022 i Kuvendit të Shqipërisë për mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese vjen në kundërshtim me nenin 70/4 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

VI. KONKLUSIONE

35. Në vijim të fakteve dhe rrethanave të çështjes, të drejtës së aplikueshme dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, analizës ligjore dhe procedurës parlamentare të ndjekur, është e qartë se deputetja dhe ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Olta Xhacka ndodhet

në kushtet e papajtueshmërisë, të përcaktuar nga neni 70, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi shoqëria “AG.TCC” sh.p.k., e cila ndodhet në pronësi të bashkëshortit të saj, Z. Artan Gaçi, e për rrjedhojë edhe në pronësi të saj, në kuptim të nenit 74 të Kodit të Familjes, dhe nenit 35 të ligjir nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka përfituar të drejta pasurore mbi pasurinë e shtetit.














36. Gjykata Kushtetuese është shprehur qartë se kërkesa për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimin e mandatit nuk i nënshtrohet debatit parlamentar, por Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetit vlerësonë vetëm përmbushjen e kritereve formale. Në çdo rast, Kuvendi duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë (shih vendimet III. 44/2011, III. 7/2016, III. 72/2016 dhe nr. 93/2016 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit për mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, janë në kundërshtim me nenin 70/4 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

37. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në nenin 70, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përfundimisht kërkojmë:

- Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve.
- Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 83, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Shqipërisë.
- Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 84 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetin për kërkesat mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Znj. Olta Xhaçka”.

Me konsideratë,

DEPUTETËT

1. Gëzment Bonlli 
2. Merita Bakciu 
3. - Selushin Juhymu 
4. Lefter Geshberga 
5. Zheri Gjergji 
6. Ferdinand Kufi 
7. ARBI RAMA 
8. ORJOLA PAMPURI 
9. Jusha Tafshu 
10. Dimer Kaveshi 
11. Gloriana Masha 
12. Bredje Kolipi 
13. Ilda Shou 
14. Doshnos Jula 